



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 2613/Prot
14

Tiranë më 14.10 2020

VENDIM

Nr. 3, datë 28.09 2020

“Mbi përfundimin e studimeve të doktoratës, të studentëve që kanë nisur studimet para se të hyjë në fuqi ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40, neni 134, pika 1, Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36 pika 4 dhe si dhe Rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, neni 9, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 28.09.2020:

VENDOSI

1. Duke marrë parasysh situatën e jashtëzakonshme të pandemisë Covid -19, si dhe fatkeqësive të tjera natyrore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, afati për dorëzimin e dosjes së doktoratës nga studentët në Departament, do të jetë deri në datën 30 Qershor 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

